



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 16.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.04.2024 të parashtruar nga operatori ekonomik **AK INVEST DOOEL TETOVO** nga Tetovaa, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik **AK INVEST DOOEL TETOVO**, e datës 08.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 02.04.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 02.04.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori ekonomik **AK INVEST DOOEL TETOVO**, me datën 08.04.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- Neni 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 51, Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes, par 1
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4

- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.2
- Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1, 6 nen paragrafi 6.1;6.2 dhe 6.5
- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6

nen par a;b dhe cIII. Rasti i OSHP-se, nr. PSH-765/2022, dt.30.03.2023,

Kriteret e përzgjedhjes

IV. Ne shkelje te interpretimeve të KRPP-se, të pyetjes 10.

Pretendimet ankimore

E kundërshtojmë në tersi njoftimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te eliminuar, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Pretendimi i parë: Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit për Kërkesën 2 në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, kinse për arsyet si ne vijim:

Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 2 te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - I pranueshëm vetëm letra nga HALKBANK me qasje te pakushtëzuar ne kredi prej 2 milion euro. Letra e ofruar nga STOPANSKA BANKA AD shënon se nuk është e pakushtëzuar dhe specifikon se letra nuk paraqet garanci bankare. E njëjtë është edhe letra nga SPARKASSE Bank mbi posedimin e 1,25 milion euro, ku shënon se nuk paraqet garanci bankare.

Arsyetimi i AK në për eliminim të Ofertës tonë, është i pa pranueshëm, sepse Komisioni për vlerësim ekzaminim dhe krahasim të tenderëve nuk i ka ekzaminuar siç duhet dhe sa duhet dokumentacionin e grupit tonë, për faktin se ne kemi mbështetje financiare prej 5,250.000.00 euro nga tri Banka të licencuara në R. Maqedonisë Veriore.

Faktet e rastit:

Kërkesa: 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).

Dëshmia: 2. *Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).*

Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë se pakushtëzuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit).

Pra, ne rastin konkret, AK në DT, të kriteret e përzgjedhjes ka kërkuar kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare - qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro, ndërsa, ne kemi ofruar mbështetje financiare nga banka HAKLBANKE, Maqedoni, në shume prej 2 milion euro, mbështetje nga STOPANSKA BANKA AD, Maqedoni në shumë prej 2 milion euro dhe mjete te gatshme nga SPARKASSE, Maqedoni në shume prej 1 milion e 250 mije euro Dhe, rrjedhimisht konsorciumi ynë i plotëson në tersi kërkesat e AK të parapara në NJK dhe DT.

Kurse AK me këtë arsyetim të eliminimit të ofertës tonë sa i përket kërkesës së lartë cekur, tejkalon kompetencat dhe autorizimet, sepse AK, nuk mund të trajtoj të papërgjegjshëm konsorciumin tonë për shkak të pa përgjegjësisë dhe sjelljeve jo profesionale të zyrtareve përgjegjës të AK, për faktin se zyrtaret përgjegjës të AK nuk i kanë të qarta kërkesat në lidhje me “mbështetje financiare” dhe “garanci bankare”, ngase këto dy dokumente kanë dallime substanciale ne mes vete.

1. 1.- Sa i përket Mbështetjes financiare, të tri provat e ofruara nga bankat si HAKLBANKE, SPARKASSË dhe STOPANSKA BANKA AD, dëshmojnë me se miri që bankat kane lëshuar letër përkrahje të pa kushtëzuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktues. Në mënyrë specifike ceket që kompania ka qasje në fonde deri në shumën e përcaktuar.

2. 2.- Sa i përket Garancisë Bankare, të paragrafi ku thuhet që kjo letër mbështetje nuk është garanci është në pajtim të plotë me kërkesat për garancione bankare, pasi garancionet bankare lëshohen sipas kërkesës për Garanci dhe kane krejt tjetër qëllim dhe funksion si p.sh. garantimin e përmbushjes së mirë të obligimeve dhe lëshohet në formatin specifik.

3.

Prandaj, bazuar në sqarimet e lartë cekura të cilat janë të dëshmuara dhe argumentuara me anë të provave të bashkangjitura dosjes së tenderit, vërteton se vendimi i AK për eliminimin e konsorciumit tonë është i pa drejtë në shkelje të kriteve të përzgjedhjes, në interpretim të pa drejtë të tyre, në shkelje të ligjit dhe rrjedhimisht është i pa qëndrueshëm

Pra, me këtë veprim, AK, shkel dispozitat e nenin 1, qëllimin, paragrafin 3, dispozitat e nenit 56, paragrafit 3 të LPP-se, sepse AK, nuk mund të diskualifikoj ose përjashtoj nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, Ngase nga arsyetimi i AK, mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me sjellje jo profesionale, jo etike dhe me tendencë për të manipuluar me dëshmitë dhe provat konkrete.

Madje, AK nuk i ka shfrytëzuar dispozitat e nenit 59, par 2 dhe nenit 72, par 1 të LPP-se dhe nenit 38, par 38.1 e RPPP, për të kërkuar informata sqaruese, sepse, atëherë ku për AK është e pa qartë, mund të kërkojë informata sqaruese, ngase është në pyetje trajtimi i barabartë i palëve sipas nenit 7, paragrafit 1,2 dhe 6 dhe nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës së vendit.

Pretendimi i dytë: Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit për Kërkesën 4.1, 4.2 deri të 4.10, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, për stafin profesional, kinse për arsyet si në vijim

Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 4.1, 4.2 deri të 4.10 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, për stafin profesional:

- Për Menaxher të projektit, e ke prezantuar z. Nuhi Nuhiu, inxh. i Ndërtimtarisë Konstruktive, i cili sipas CV-së është i punësuar në kompaninë ENGRUP Shpk. Kontrata e prezantuar për Projektin, në mes Hidro Project dhe Nuhi Nuhiu, të fleta e noterizimit nder të tjera thekson se: ...dokument i cili ka 1 fletë dhe 1 faqe, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me parë se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në zyrën time. Pala deklaron se origjinalin nuk e posedon me vetë. Kjo kontratë është e pa pranueshme për AK.
- Për Inxhinierin kryesor të punës Inxhinier i Operativës në teren, e ke prezantuar z. Safet Lipovica, inxh. i Ndërtimtarisë, i cili sipas CV-së me punë primare është në BKT, ndërsa sekondare në Beni Com. Kontrata e prezantuar për Projektin, në mes Hidro Project dhe Safet Lipovica, të fleta e noterizimit nder të tjera thekson se: ...dokument i cili ka 1 fletë dhe 1 faqe, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me parë se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në zyrën time. Pala deklaron se origjinalin nuk e posedon me vetë. Kjo kontratë është e pa pranueshme për AK.
- E njëjta formë e noterizimit është edhe për inxhinierët tjerë të prezantuar: inxh. Arkitekturës z. Blerim Bajraktaraj, inxh. e Ndërtimtarisë z. Arberesha Kastrati, inxh. Hidroteknik z. Shpat Klaiqi, inxh. i Elektros z. Bujar Gjocaj, inxh. i Makinerisë z. Halim Halimi, inxh. i Gjeodezisë z. Fisnik Ismaili, Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë z. Sami Loka.

Faktet e rastit:

Kërkesa 4.1. Një Menaxher i Projektit - Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve të punimeve ndërtimore (se paku një objekt spitalor).

Dëshmia: 4.1. *Vendimi për caktimin e Menaxherit te projektit, Diploma e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri, Kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt, (e noterizuar), Referencat për përvojën sipas kërkesës.*

Në rastin konkret AK na eliminon pa drejtësisht nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se “kontrata është e pa pranueshme për AK”, prandaj edhe ne këtë rast AK tejkalon kompetencat dhe autorizimet ligjore sepse nuk mund të diskualifikoj një tenderues për kërkesa/kritere të pa parapara në NJK dhe DT, për faktin se po t’i referohemi kërkesës së AK, nuk është kërkuar që inxhinieri të mos jetë i punësuar edhe në kompani tjetër dhe nuk është kërkuar që kontrata duhet të prezantohet të noteri në formatin origjinal, por është kontratë e noterizuar, gjë që, sipas kërkesave të AK, kontrata për inxhinierin ne fjalë është në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Po ashtu edhe për inxhinierin e Operatives, të Ndërtimtarisë, të Hidroteknikës, të Elektros, të Makinerisë, të Gjeodezisë dhe ekspertit për siguri dhe shëndet në punë, të gjitha kontratat janë në përputhje të plotë me kërkesat e AK sepse të gjitha janë të noterizuar.

Prandaj, janë të pa pranueshme, të pa drejta, të qëllimshme dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, pretendimet e AK për të eliminuar konsorciumin tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit për shkak se me këtë veprim AK bënë shkelje të dispozitave të nenit 51, par 1; nenit 59, par 4 të LPP-së dhe në shkelje të nenit 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c, të Rregullores 01_2022 të KRPP-së, për faktin se, tani ne këtë fazë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve aplikon kritere tjera në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, sepse GOE i kanë plotësuar në tersi kriteret e përzgjedhës të paraparë nga AK në NJK dhe DT, ngase provat janë argumenti me i fuqishëm që dëshmojnë faktet e rastit, si ne rastin konkret, dëshmitë dhe provat në fjalë janë të pa kontestuara!

Prandaj, duke u bazuar në dëshmitë bindëse të ofruara nga ana jone me rastin e dorëzimit të tenderit, jemi të bindur se veprimet AK për të eliminuar ofertën tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit janë diskriminuese, të pa drejtë, tendencioze dhe në shkelje të Ligjit dhe rrjedhimisht janë të pa pranueshme, sepse jemi të përgjegjshëm sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin me te ulet sipas kriterëve për dhënie të kontratës.

Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore Njoftimit të Vendimit të AK për rezultatin e tenderit të datës 02.04.2024.

E kundërshtojmë në tersi vendimin e AK, lidhur me letrën standarde B58, për faktin se vendimi i AK për dhënie të kontratës është i pa drejtë dhe në kundërshtim të plotë me LPP-në dhe dokumentacion dytësorë të KRPP-se, sepse shpërblen me kontratë OE “BM Group”, Prishtinë edhe pse OE në fjalë është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT.

Sepse pas qasjes në dokumente të OE të rekomanduar për kontratës mund të vërtetohet së “BM Group”, Prishtinë nuk është i përgjegjshëm për shkak të:

E para: OE “BM Group”, Prishtinë, nuk e plotëson kushtin administrativ mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesat e pikës 2 të FDT.

Faktet e rastit:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashmendërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, **gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë.** Ne rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia: 2. *Një Listë të projekteve të realizuara - Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet t’i ketë këto të dhëna Titulli i kontratës, Investitori, Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit, Vlerën e projektit. Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura. Për çdo projekt të realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t’i verifikoj transaksionet financiare).*

Pas qasjes në dokumente të OE fitues, të lista e punëve të kryera, dëshmon me se miri së OE i propozuar për shpërblim me kontratë nuk e plotëson kushtin për kontrata të perfunduara prej 25 milion euro si dhe OE nuk e plotëson kushtin sipas *Sipas NJK* së së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj, pune keto të cilat nuk janë të perfshira në asnjeren kontratë.

OE i lartë cekur ka ofruar një listë ku në listë ka përfshirë edhe kontrata të cilat janë në realizim dhe të cilat nuk mund të pranohen nga ana e AK, sepse po ti referohemi kërkesës së AK, ku ceket se gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë deri sa OE ka kontrata aktive për vitet 2024 e tutje.

Lista e punëve të kryera të prezantuar nga BM Group, fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 25, ndërsa shuma totale e këtyre kontratave ka vlerën prej 30,901,003.51 euro, por, që në kuadër të kësaj liste, OE ka të përfshira edhe 6 kontrata të pa përfunduara deri me datën 07.01.2024, (kontratat në numrin rendor 2; 14; 18; 19; 24 dhe 25) e që në total shume e këtyre kontratave është 11,906,177.16€, ndërsa kontratat me nr rendor sipas listes së prezantuar 1; 2; 3; 9; 15; 23; dhe 25 janë kontrata që nuk janë të pershtatshme për këtë procedurë të prokurimit pasi që një pjesë e tyre është furnizim sic e kemi elaboruar në këtë kërkesë dhe bie ndesh me kërkesat e NJK dhe DT, ku në rastin konkret OE i lartë cekur punë të kryera ka vetëm 12,812,117.80€.

Për më tepër, ju lutemi referoju interpretimit të KRPP-së, pyetjes 10, ku nder të tjera sqaron, citojmë: ... në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës.

Po ashtu OE ka prezentuar Kontrate të furnizimit në mes të OE fitues dhe Bau Holding për furnizim derisa i njëjti i është referuar si Kontrate për Nderim, të lista e kontratave, kontrata në fjalë është në numrin rendor 1, e datës 08/01/2018, e përfunduar me 08/07/2022. Vlera e kontratës: 1,435 818.68, që bie ndesh me referencën e datës 08/07/2022, që i referohet përfundimit të pjesërisht të stadiumit të Gjilanit, përfshirë kontrata me nr rendor 3 nuk përputhet numëri i prokurimit në listë dhe kontratës së prezantuar. Derisa për kontratën me nr rendor 5 është paraqitur referenca e punëve të përfunduara pa date të përfundimit.

Po ashtu OE ka prezentuar Kontrate të furnizimit në mes të OE fitues dhe IP Petrol për furnizim derisa i njëjti i është referuar si Kontrate për Nderim, të lista e kontratave, kontrata në fjalë është në numrin rendor 9, e datës 06/08/2021, të cilës i mungojnë të dhënat – datat e referencës.

Po ashtu OE ka prezentuar Kontrate të furnizimit në mes të OE fitues me Britania Homes shpk, kontrata me nr rendor 15 dhe 23 që i referohen furnizimit që bie ndesh me kërkesat me NJK dhe DT, ku kontrata me nr 15 nuk është e prezantuar fare në dosje të tenderit.

Për më tepër, ju lutemi referoju interpretimit të KRPP-së, pyetjes 10, ku nder të tjera sqaron, citojmë: ... në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës.

E dyta: OE “BM Group”, Prishtinë, nuk e plotëson kushtin administrativ mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesat e pikës 3 të FDT.

Faktet e rastit:

Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me Staf Teknik min. 50 punëtor, prej tyre se paku 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë.

Dëshmia: 3. - Lista e stafit min. 50 punëtor, me profilin teknik të punëtorit, Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt, Certifikatat e trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, për min. 20 punëtorë. Për 12 udhëheqësit b) kërkojnë të Noterizuar Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt dhe diplomat e shkollës së mesme teknike..

Po ashtu referuar listës së punëtorëve për vitin 2024 dhe certifikimit të tyre sipas kërkesës së NJK dhe DT, OE në fjalë ka të certifikuar vetëm **16 punëtor për siguri dhe shëndet në punë** e që nuk e plotëson kushtin administrativ për të qenë i përgjegjshëm.

Kërkesa sipas AK Lista e stafit min. 50 punëtor, me profilin teknik të punëtorit, – Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Pjesë stafit të pezantuar në liste prej **50 punëtorëve** nuk janë me kontratë për tërë periudhën e projektit sipas NJK dhe DT, kontratat e të punësuarve të BM Group, skadojnë me datën **31.12.2024** si dhe nuk janë kontrata ose marrëveshje për këtë projekt sipas NJK dhe DT.

Referuar edhe listës së stafit Për 12 udhëheqësit b) kërkohen të Noterizuara Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt dhe diplomat e shkollës së mesme teknike ose certifikata profesionale të dhënë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, OE në liste ka të prezantuar në total 14 puntore, në mesin e tyre plotësojnë kushtin vetëm 8 puntor dhe pjesa tjetër sipas listës:

2.-**Abdyl Morina** i prezantuar si Elektracist nuk e plotëson kushtin për arsye : OE ka prezantuar diplomën e bachelorit të elektros

7.-**Isa Gashi** i prezantuar si Hidroizolues nuk e plotëson kushtin për arsye: OE ka prezantuar një certifikatë e leshuar nga një kompani private Sika Serbia

8.-**Besart Gashi** i prezantuar si Instalues i ngrohjes qendrore nuk e plotëson kushtin për arsye: OE ka prezantuar diplomën e bachelorit të makinerisë.

9.-**Egzon Hoti** i prezantuar si Instalues i gazit nuk e plotëson kushtin për arsye: OE ka prezantuar diplomën e bachelorit të makinerisë.

12.-**Fetah Meliqi** i prezantuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve nuk e plotëson kushtin për arsye: OE ka prezantuar diplomën e shkolles së mesme ndërtim të lartë.

13.-**Sami Elezi** i prezantuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve nuk e plotëson kushtin për arsye: OE ka prezantuar trajtim 1 ditore nga një kompani private Arch/techtural Aluminium Academy.

E treta: OE “BM Group”, Prishtinë, nuk e plotëson kushtin administrativ mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesat e pikës 4.1 të FDT.

Faktet e rastit:

Kërkesa 4.1.Një Menaxher i Projektit - Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve të punimeve ndërtimore (se paku një objekt spitalor)..

Dëshmia: 4.1. CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri.

Po ashtu referuar dokumenteve të inxhinierit të arkitekturës, rezultojnë se CV e inxhinierit **nuk është e nënshkruar sipas kërkesës në NJK dhe DT** dhe, rrjedhimisht edhe në këtë rast OE nuk e plotëson kushtin administrativ për të qenë i përgjegjshëm.

Pra, AK në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, shkel dispozitat e nenit 51, paragrafit 1 të LPP-se dhe nenin 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nën par a;b dhe c të rregullores 01/2022, ngase OE nuk e plotëson kushtin administrativ për të qenë i përgjegjshëm për shkak OE “BM Group” Shpk nuk i plotëson kërkesat profesionale/teknike të nenit 69, par 1, par 6 nën paragrafi 6.1;6.2 dhe 6.5 të LPP-se.

Prandaj, me anë të kësaj kërkesë për rishqyrtim, pretendojmë se AK në kundërshtim të plotë me nenin 56, par 1, nën par 1.1 dhe 1.2 dhe nenin 60, par 1, nën par 1.2, e LPP-se, shpërblen me kontratë për OE “BM Group” Shpk edhe pse është i pa përgjegjshëm.

Për më tepër, kriteret e përzgjedhjes janë qënsore për një vlersim të drejtë dhe meritore, për faktin se janë kusht administrativ, prandaj në lidhje me këtë ju jemi referuar vendimit të OSHP-se, nr. PSH-765/2022, dt.30.03.2023, si rast i ngjashëm, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes.

Ku nder të tjera citojmë arsyetimin e OSHP-se ku precizon se: [...], kurse DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hire të sigurisë juridike, me paragrafin 3 të nenit 7 të LPP-se, *çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangieje nga termat dhe kriteret e precizuara në DT, sepse sipas paragrafit 1, të nenit 27 kanë karakter material, kurse devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së.*

Në lidhje me këtë, AK ne mënyre të pa drejtë ju është shmangur kriterëve të përzgjedhjes të precizuara në DT, për me teper aplikon standarde të dyfishta ku ne rastin e konsorciumit tonë aplikon kriteret shtese të pa parapra ne NJK dhe DT, kurse në rastin e OE "BM Group" Shpk, edhe pse nuk i plotëson kriteret e NJK dhe DT, e trajton të përgjegjshëm, e që, ne rastin konkret kemi trajtim jo të barabartë të OE pjesmarres ne këtë aktivitet, duke shkelur dispozitat e nenit 7, paragrafët 1, 2 dhe 6, të LPP-se, ku, ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është siguri i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbare dhe jo diskriminuese.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëjlojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Sidoqoftë, në asnjërin nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi, kështu, Operatori Ekonomik OE "BM Group" Shpk, mbeti në garë edhe në procedurën e kriterëve të vlerësimit, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar duke u shpërblyer me kontratë pa i plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe pa qenë OE i përgjegjshëm.

Prandaj, pretendimet tona sa i përket dispozitave ligjore të shkelura nga AK qëndrojnë sepse janë ta bazuara dhe te argumentuara dhe të mbështetura në Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit publik

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga AK, që kërkesën për ri-shqyrtim ta trajtoj me pajtueshmëri më dispozitat ligjore të LPP-se, ta trajtoj ne pajtueshmëri të plotë me kërkesat e parapara ne njoftim për kontratë dhe dosjes së, SEPSE KY ËSHTË EDHE QËLLIMI I LPP-së.

Dhe, si përfundim të nxjerr:

VENDIM

Të nxjerrë vendim meritot me të cilin të aprovoj kërkesën për rishqyrtim të bazuar të paraqitur nga GOE "AK INVEST DOOEL" Tetovë dhe "HIDRO PROJECT" shpk, Tetovë;

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Sa i përket pretendimit te parë ankimor rreth arsyes se eliminimit per shkak te mbeshtetjes bankare, nuk pajtohemi me kete pretendim dhe njekohesisht e konfirmojme Njoftimi mbi Vendimin e AK te datës 02.04.2024, me arsyet e cekura ne **B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar**, se:

Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - I pranueshëm vetëm letra nga HALKBANK me qasje te pakushtëzuar ne kredi prej 2 milion euro. Letra e ofruar nga STOPANSKA BANKA AD shënon se nuk është e pakushtëzuar dhe specifikon se letra nuk paraqet garanci bankare. E njëjtë është edhe letra nga SPARKASSE Bank mbi posedimin e 1,25 milion euro, ku shënon se nuk paraqet garanci bankare.

Dy garancionet e ofruara nga ana juaj **STOPANSKA BANKA AD** dhe **SPARKASSE Bank** nuk i konsiderojme te pakushtezuara siç jane kerkuar, duke marre parasysh permbajtjen si ne vijim:

SUBJECT: Letter of intent

Our client, The Construction Company AK INVEST Doel Tetovo with headquarters at Str.101 No. 5, Falish, Tetovo, Reg. No. 6015140, notified us on their intention to participate in the tender 206-23-14371-5-1-1 " Continuation of Construction - Center of Emergency Medicine in KKUK " announced by the Ministry of Health of Republic of Kosovo

With regard to the above-mentioned, we hereby declare that, the company has access to financial funds in the amount up to EUR 2.000.000,00 , in accordance with the business policy and legal regulations of the Bank.

We hereby notify that this Letter of intent does not represent a bank guarantee.

Subject: Information letter

Our client, 'AK INVEST' DOOEL, Str. 101 No.5 Falish, informed us that they are preparing documentation to apply for the Tender - Title: Continuation of Construction - Center of Emergency Medicine in KKUK. Procurement No 206-23-14371-5-1-1.

In reference to abovementioned, we, Sparkasse Banka AD Skopje, Macedonia with registered office Vasil Iljoski 14,1000 Skopje, Macedonia (hereinafter: the Bank) declare on 15.02.2024 that the client has available funds with a total amount of EUR 1.250.000,00 in accordance with the performed assessment of the Client's creditworthiness.

Hereby we declare that this information letter does not represent a bank guarantee.

Sa i përket pretendimit të dytë dhe të tretë ankimor, rreth arsyes së eliminimit për shkak të mospranimit të noterizimit të kontratave për inxhinieret, nuk pajtohem me këtë pretendim dhe njekohesisht e konfirmojmë Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 02.04.2024, me arsyet e cekura në **B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku në NJK dhe DT për të gjithë inxhinieret, në mesin e deshmive janë kërkuar - ***Kontratat ose marrëveshje të punës për këtë projekt (të noterizuara)***, ndërsa të fleta e noterizimit që ju i keni prezantuar ndër të tjera thekson se: *...dokument i cili ka 1 fletë dhe 1 faqe, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me parë se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Liqjit është bërë në zyrën time. Pala deklaron se origjinalin nuk e posedon me vete.*

Ju i keni prezantuar noterizimet në formën si më poshtë:



REPUBLIKA E KOSOVES
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.Nr. 2089/2023.-----
VERTETIM I KOPJES NGA KOPJA E ZAKONSHME -----
Unë Zyfer Aliu, Noter në Lipjan, Rr. "Lidhja e Prizrenit" p.r, me kërkesë të Z.Xhavll Ahmetaj i lindur në F.Isniq-Deçan, me dt. 27.02.1985 (njëzet e shtatë shkurt njemijë e nentëqind e tetëdhjetë e pesë), me vendbanim në F.Isniq-Deçan, shtetas i Rep. së Kosovës, bartës i Letërnjoftimit me numer personal 2500505357, të lëshuar nga MPB-Prishtinë me date 19.01.2016 valid deri më 18.01.2026, madhor, me zotesi të plotë veprimi, vërtetoj se dokumenti bashkangjitur me titull
"Kontrate per projektin me titull Vzhdim i Nderitmit-Qendra e Mjekesise Emergjente ne QKUK 206-23-14371-5-1-1" lidhur me dt.07.02.2024 ndermjet HIDRO PROJECT SHPK dhe Fisnik Ismaili , dokument i cili ka 1 flete dhe 1 faqe, përputhet në çdo aspekt me kopjen e zakonshme , më parë se me dokumentin origjinal, i cili nuk më është prezentuar.----

Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në Zyrën time. Pala deklaron se origjinali nuk e posedon me vete.-----
Në mbështetje të nenit 43, pika 3.2. të Ligjit nr. 03/L-010 "Për Noterinë", të njëjtin e vërtetoj Tarifa noteriale në shumë prej 1€ + 0.10€ për çdo faqe të fotokopjuar (neni 42.1 TN) = 1.10€ + 18% TVSH= 1.30€ (një euro e 30/100) dhe është paguar konform UA, Nr.05/2022, mbi Tarifat noteriale.-----

Lipjan, 14.02.2024 (katermbedhete shkurt dymijë e njëzet e kater).-----



Sa i perket pretendimit (arsya e gjashte) se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar kriterin rreth puneve te kryera ne projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Million Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë, nuk pajtohemi me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar Listen e projekteve ne total 30,901,003.51 euro, ku vetem me UNOPS i ka mbi 4.7 milion euro, mbi 6.2 milion euro ne Punimet ne Parkun Industrial ne Miradi, mbi 4.3 milion ne lagjen Marigona Hill, mbi 3.3 milion ne qendren Park Plaza Podujeve, mbi 1.3 milion euro ne parkingun e Prishtines, mbi 1.7 milion ne stadiumin e qytetit te Drenasit, etj.

Ne lidhje me pretendimin se OE I rekomanduar nuk ka kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj, kjo nuk qendraon, meqense OE i rekomanduar I ka kryer punimet per UNOPS si me poshtë:

10	BM GROUP SH.P.K	Rehabilitation of Clinic Radiology in General Hospital in Ferizaj	Korrik 2021	Shtator 2021	179,637.45 euro	UNOPS	Sherafedin Mustafa sherafedinM@unops.org Nr. 045 11 22 33
11	BM GROUP SH.P.K	Demolition and landscaping works for the central vaccine storage in Prishtina, Kosovo	05/06/2021	30/09/2021	38,902.20 euro	UNOPS	Sherafedin Mustafa sherafedinM@unops.org Nr. 045 11 22 33
12	BM GROUP SH.P.K	Construction of the Central Vaccine Storage	05/10/2021	30/06/2022	780,321.40 euro	UNOPS	Sherafedin Mustafa sherafedinM@unops.org Nr. 045 11 22 33
13	BM GROUP SH.P.K	Renovation-Upgrade of Medical Gases in Five Regional Hospitals	15/09/2021	30/06/2022	1,748,292.63 euro	UNOPS	Sherafedin Mustafa sherafedinM@unops.org Nr. 045 11 22 33
14	BM GROUP SH.P.K	Construction Contract for Major Works - UNOPS WP1)	28/12/2022	31/01/2024	2,009,421.26 euro	UNOPS	Verona Ymeri veronay@unops.org Nr. Tel: +383 248 861

2.9.2	D2 (80x210cm)	psc	5	€220.00	€1,100.00
2.9.3	D4 (100x210cm) sliding door	psc	1	€280.00	€280.00
	Doors with radiation protection X-ray (CT and Mammography room), thickness door 5cm and lead plate t=2mm (standard DIN 6834) together with X-ray resistant glass. Doors equipped with all necessary mechanisms and accessories; door mechanism and locks, automatic controllers and electric lock for entry control systems, access control devices and all fixing elements until operational. The color is determined by the designer/ investor. Doors to be installed according to the manufacturer's manuals.				
2.9.4	D5 (110x210cm)	psc	3	€1,200.00	€3,600.00
2.9.5	D6 (80x210cm)	psc	1	€1,100.00	€1,100.00
2.9.6	D7 (165x210cm)	psc	1	€1,500.00	€1,500.00
2.9.7	Installation of the window (120x80cm) in CT Control Room with radiation protective profiles and glasses X-ray according with DIN EN 12163	psc	1	€650.00	€650.00
2.9.8	Installation fire resistant door (D8-110x210cm) to 90min with fire resistance tested to EN 1634. Door should have ventilation aluminium return air grill with dimensions -40x10cm placed on lower part of it, according to the technical specifications.	psc	2	€850.00	€1,700.00

Klimatizim

				Total for Item 4.2	€10,502.50
4.3	Climas - Air Conditioner				
4.3.1	Multi Split 4x1 - 48000 Btu Outdoor unit, R32, 2 Indoor units 12000 Btu and 2 Indoor units 9000 Btu, Wall Mounted, Cable installation from outdoor to indoor units, Heating, Cooling, Working temperatures to -20 degrees for winter season - heating, +35 degrees for summer season - cooling A++ - Efficiency	compl.	1	€3,400.00	€3,400.00
4.3.2	Multi Split 3x1 - 48000 Btu Outdoor unit, R32, 2 Indoor units 18000 Btu and 1 Indoor units 12000 Btu, Wall Mounted, Cable installation from outdoor to indoor units, Heating, Cooling, Working temperatures to -20 degrees for heating - winter season, + 35 degrees for cooling - summer season A++ - Efficiency	compl.	2	€3,050.00	€6,100.00
4.3.3	Split Clima 1x1 - 12000 Btu, Outdoor unit and Indoor unit, Wall mounted, Cable, Installation, Heating+Cooling, Working Temperatures -20 degrees for winter season (Heating), and +35 Degrees for summer season (Cooling), A++	compl.	2	€700.00	€1,400.00
4.3.4	Air curtain: air flow 2900m ³ /h, Instalation height 2.2-2.8m, Dim 1950mmx300mm	compl.	1	€850.00	€850.00
4.3.5	Ø9.52 Cooper Pipe with insulation	m'	82	€3.80	€311.60
4.3.6	Ø6 - Cooper Pipe with insulation	m'	82	€2.70	€221.40
4.3.7	Ø12 - Cooper Pipe with insulation	m'	22	€4.95	€108.90
4.3.8	Condensate Pipe Ø32	m'	50	€2.00	€100.00
4.3.9	Installation with electricity cable 3x2.5mm	m'	120	€1.50	€180.00
4.3.10	Gas R32 - additional Gas	kg	12	€18.00	€207.00
4.3.11	Holes for the copper gas pipes and for condensate	compl.	20	€5.00	€100.00
				Total for Item 4.3	€12,978.90
4.4	Heating System				
Installation of new Steel Radiators with holders and complete for installation with pipes Type 22,					

Ju rikujtojme se permes Sqarimeve shtese te publikuara me daten 05.02.2024 eshte lehtesuar ky kriter, ku eshte specifikuar se "1. *Pranohen edhe investimet private (si investime ne ndërtim te ndërtesave afaristo banesore). Pranohen objektet individuale, pranohen ambulatat.*"

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk e ka prezantuar stafin prej 50 punetor, nuk pajtohemi me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar 51 punetor, te gjithe me certifikata profesionale per siguri dhe shëndet në punë, ne emrin e tyre edhe ne emer te kompanise.

Si shembull shih njerin prej tyre:



Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk i ka ofruar 12 udheheqesit e punetoreve me kualifikimet e kerkuara me diploma te shkules se mesme teknike, ky pretendim eshte i pa bazuar, duke marre parasysh se udheheqesit ne fjale OE i rekomanduar i ka ofruar me klualifikimet Bachelor te drejtimeve inxhinierike, duke e tejkaluar kerkesen e AK.

Sa i perket pretendimit se te OE i rekomanduar Inxh. I Arkitektures nuk e ka nenshkruar CV sipas Kerkese se NJK dhe DT, ky pretendim eshte i pa bazuar dhe jo serioz, meqense ne dokumentacionin e ofertes ekziston CV e z. Arben Meha e formatit EUROPASS e nenshkruar, me deshmi per experience shume te madhe te ketij inxh, gjithashtu jane te gjitha dokumentet e kerkuara, kontrata e noterizuar, diploma e noterizuar, referencat e mjaftueshme, etj.

Arben Meha



Date of birth: 08/11/1978 Nationality: Kosovar Phone number: (+383) 44195167 (Work) Email address: arben.meha@gmarchitecture.com Address: Str. Rrustem Statovci, 33/41, 10000, Pristina, Kosovo (Home)

WORK EXPERIENCE

2005 – CURRENT Pristina, Kosovo
ARCHITECT - PROJECT MANAGER GM ARCHITECTURE

Projektit e kulturës - trashëgimisë Arkitekturore -nën mbrojtje:

1. Projekti "Kisha e Shën Marisë" Rubik - Shqipëri / Investitori: UNOPS 2021
2. Projekti "Kisha e Shën Ndoit" Rodon - Shqipëri / Investitori: UNOPS 2021
3. Projekti "Muzeu Etnografik" Kavajë - Shqipëri / Investitori: UNOPS 2021
4. Projekt, renovimi i "Tatrit Nacional të Kosovës" / Investitori: MKRS 2018.

1. Projekti "Qendra e Kulturës Nexhmije Pagarashuë" Malishevë / Investitori: MKRS 2021.

2022

- Shërbimet e rishikimit të dizajnit të projektimit të shkollës Evropiane në Tbilisi -Gjorgji/ Zbatuar nga UNOPS.
- Projekti ideor dhe kryesor për "Ndërtesën me konsum të energjisë afër zero (nZEB)" në ITP Prizren/ Zbatuar nga GIZ/ Vlera e investive ~1.8M €.
- Projektimi i sigurisë nga zjarri për gjashtë Spitale Rajonale në Kosovë / Zbatuar nga UNOPS:
- Projekti ideor dhe kryesor për kompleksin banesor me afarizem "DUA" në Veternik Prishtinë, S=11900m².
- Projekti ideor dhe kryesor për kompleksin banesor me afarizem "Anea Residence" S=198200m². Investitor: Agribau Invest /Vlera e investive: 33M €/Projekti final.
- Mbikëqyrja e punëve të renovimit të zyrës qendrore për PCB Lakrishte Prishtinë. Investitori: Procredit Bank Vlera e investive: 1.4 milion €
- Mbikëqyrja e punimeve të 130 shtëpive në lagjen "Priam Village Prishtina" në Prishtinë. Investitori: New Prishtina Residence shpk/ Vlera e investive =15.5M€/ Projekti final.
- Projekti ideor dhe kryesor për 4 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: Privat.

2021

- Projekti ideor dhe kryesor për "Renovimi i morgut në Prishtinë"/Zbatuar nga UNOPS/
- Projekti ideor dhe kryesor për "Depoja qendror e vaksinave në Prishtinë" / Zbatuar nga UNOPS/
- Projekti për "Renovimin e gjashtë spitaleve rajonale të Kosovës/Zbatuar nga UNOPS Vlera e projektit ~2M€
- Koncepti dhe dizajni i detajuar "Rehabilitimi i klinikës së radiologjisë (skaneri i ri CT) në Ferizaj"/ Zbatuar nga UNOPS/
- Projekti ideor dhe kryesor për "Qendra e Kulturës Nexhmije Pagarashuë" Malishevë / Investitori: MKRS.
- Projekti per restaurimin e 3 ndërtesave trashëgimi kulturore ne Shqipëri: 1. "Kisha e Shën Marisë" Rubik Shqipëri; 2. "Kisha e Shën Ndoit" Rodon - Shqipëri / Investitori: UNOPS 2021; 3. "Muzeu Etnografik" Kavajë - Shqipëri / Investitori: UNOPS / 2021
- Studimi i fizibilitetit të 14 infrastrukturave shkollore në Kosovë. Investitori: Komisioni Evropian / Projekti Final/ Vlera e financiare=6.4M€
- Mbikëqyrja e Punëve të Renovimit të Zyrës Qendrore (10 kate - 3400m²) për PCB Prishtinë.
- Investitori: Pro Credit Bank / Projekti final.

2020

- Mbikëqyrja e punëve "Renovimi i zyrës qendrore (10 kate-3400m²) për PCB Prishtinë./Pro Credit Bank.
- Projekti per renovimin e katit të 4-të në zyrën e BE-së /2019-2020. Investitori: BE
- Projektimi dhe mbikëqyrja e detajuar "Punimet e ndryshimit të katit të 4-të të objektit aneks të zyrës së BE-së në Prishtinë" /2020. Investitori: BE
- Mbikëqyrja e punimeve të 130 shtëpive në lagjen "Priam Village Prishtina" në Prishtinë. Investitori: New Prishtina Residence shpk
- Projekti ideor dhe kryesor për 3 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: privat.

2019

- Projekti per renovimin e katit të 3-të në zyrën e BE-së /2019-2020. Investitori: BE
- Projekti-vlerësimi dhe përgatitja e projekti detal për renovimin e ndërtesës së "Agjencisë së Metrologjisë" /2019. Vlera e projektit=1.6 M€ Investitori: Banka Botrore
- Projekti ideor dhe detal i enteriери dhe mbikëqyrja e punimeve në Zyrën Qendrore të Raiffeisen Bank, Prishtinë Kosovë/2019. Vlera e projektit: 7.5 M€

CV Arben Meha, - Arkitekt

1

- Projekt i ideor dhe kryesor për Qendrën kombëtare të Tenisit në Prishtinë/2019. Vlera e projektit=2.3 ME
Investitori: MKRS
- Projekt i ideor dhe kryesor për 4 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: privat.

2018

- Projekt i ideor dhe kryesor për i Shkollës fillore dhe të mesme në Malishevë. Investitor: Ministria e Arsimit.
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2018 financuar nga Raiffeisen Bank në Kosovë.
- Zgjidhje urbanistike për lagje banimi (2 hektarë) me shtëpi individuale në Bernicë - Prishtinë.
- Projekt i ideor dhe kryesor për 5 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: Privat

2017

- Projekt i ideor dhe kryesor për lagje banimi Priam Village Prishtina, (15 hektarë) me 130 shtëpi individuale në Çagllavië - Prishtinë. Investitori: New Prishtina Residence. Vlera e investive =15.5ME/ Projekt i final
- Mbikëqyrja e renovimit të objektit të ish- shtabit ushtarakut të MPMS-së në Prishtinë. Investitori: EU.
- Projekt i ideor dhe kryesor për Fermen e qenve K9 në kampin Vrellë – Sllatinë, Investitor: Policia e Kosovës
- Projekt i ideor dhe kryesor i objektit komercial dhe banesor (B+R+Kati+10 kate) në Velania, Prishtinë.
Investitor: Dardania SH Company. Vlera e investive =3.5ME
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2018 financuar nga Raiffeisen Bank në Kosovë. Vlera e Projektit=4.5ME

2016

- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2016 financuar nga Raiffeisen Bank në Kosovë, VP=3.2ME.
- Projekt për restaurimin e pjesëshem të Teatrit Kombëtar të Kosovës. Investitori: MKRS.
- Projekt i ideor dhe kryesor i Stacionit Policor në Radavo.
- Projekt i ideor dhe kryesor i Stacionit Policor në Partesh.
- Projekt i ideor dhe kryesor i Palestres Sportive në Samadrixhë-Vushtrri. Investitori: MKRS.
- Projekt i ideor dhe kryesor "Spitali Gjinekologjik dhe Obstetrik" Çagllavicë. Investitor: Dr.dr.Med. Imer Hajdari.
Vlera e investive =2.8ME
- Projekt i ideor dhe kryesor për 8 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: privat.

2015

- Projekt i ideor dhe kryesor për: "Kopshti Arbëri 3" Prishtinë, Investitor: Komuna e Prishtinës.
- Projekt i ideor dhe kryesor për i klinikës së kardiologjisë "Al Med", Prishtinë. Vlera e Projektit=260,000ME.
- Projekt i ideor për Hotelin "Dardania" Brezovicë-Kosovë. Investitor: Kompania Dardania..
- Projekt i ideor dhe kryesor për "Fabriken e dritarve" Çagllavica-Prishtine. Investitor: "Durmishi" shpk
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2015 të financuara nga Raiffeisen Bank në Kosovë.
- Projektimi i detajuar: "Faza VII, Loti 2 & 3" (6 shkollave: Kamenicë, Podujevë, Novobërdë, Gjilan, Killokot, Pasion), Investitori: Komisioni Evropian / = 4.9ME.

2014

- Projekt i ideor për: "Faza VII, Loti 2 & 3" (6 shkolla: Kamenicë, Podujevë, Novobërdë, Gjilan, Killokot, Pasion),
Investitori: Komisioni Evropian
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2014 financuar nga Raiffeisen Bank në Kosovë. VP =6.8ME
- Konkursi – koncept projekt (vendi i dytë) Salla e Sporteve në Viti. Investitori: MKRS.
- Projekt i ideor dhe kryesor për 3 shtëpi private individuale në Prishtinë. Investitori: privat.

2013

- Projekt i ideor dhe kryesor për Shkollën fillore në lagjen Matë 1, Prishtinë. Investitori: Komuna e Prishtinës.
- Projektet kryesore të infrastrukturës në Kosovë për vitin 2013. Investitori: Mercy Corps.
- Plani urbanistik (pjesa 2) për lagjen "Hasan Prishtina" - Çagllavice, Prishtinë, Investitori: Prishtina New Residence.
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2013 të financuara nga Raiffeisen Bank në Kosovë. VP=5ME


2012

- Projekt i ideor dhe kryesor për "Pishinën e Gërmisë", Investitor: Komuna e Prishtinës. Vlera e investive =1.5ME
- Projekt i ideor dhe kryesor për vitin 2012 për Komunën e Vushtrisë. Vlera e Projektit=1.2M
- Projekt i ideor dhe kryesor "Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuar", Investitori: Universiteti i Prishtinës. Vlera e Projektit=13.8ME
- Projekt i ideor dhe kryesor për "Tri parkingje të hapura në Lipjan, Qendra 2", Investitori: Komuna e Lipjanit.
- Projekt i ideor dhe kryesor për "Shkollën fillore në fshatin Rubovcë", Investitori: Komuna e Lipjanit.
- Projekt i ideor dhe kryesor për "Kopshtin në Lipjan", Investitor: Komuna e Lipjanit. Vlera e Projektit=340,000€
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale për vitin 2012 të financuara nga Raiffeisen Bank në Kosovë. VP=4.5ME

2011-2005 upon request

Email info@omarchitecture.com | Website www.omarchitecture.com

CV Arben Meha, - Arkitekt




2

● **EDUCATION AND TRAINING**

01/10/1998 – 01/04/2008 Prishtinë, Kosovë
INXHINIER I DIPLOMUAR I ARKITEKTURËS
Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
Website <https://fa.uni-pr.edu/>

03/2015 – 04/2015 Prishtinë, Kosovë
LICENCË PËR MBROJTJE NGA ZJRRRI
Ministria e Punëve të Brendshme – Agjensioni për Menaxhim të Emergjencave
Website <https://ame.rks-gov.net/>

2023 Prishtinë, Kosovë
LICENCË PROFESIONALE "A1" Në fushën e trashëgimisë kulturore.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Website <https://www.mkrs-ks.org/>



● **LANGUAGE SKILLS**

Mother tongue(s): **ALBANIAN**

Other language(s):

	UNDERSTANDING		SPEAKING		WRITING
	Listening	Reading	Spoken production	Spoken interaction	
ENGLISH C2		C2	C2	C2	C2
SERBIAN C1		C1	C1	C1	C1
GERMAN B2		B2	B2	B2	B2

Levels: A1 and A2: Basic user, B1 and B2: Independent user, C1 and C2: Proficient user

● **DIGITAL SKILLS**

Autodesk Archicad | Microsoft Office | AutoCad 2D-3D

Gjate vleresimit te ketij aktiviteti AK ka pasur parasysh nenin 1 te LPP-se Qellimin e aktivitetit per realizimin e projektit, duke e rekomanduar per kontrate OE sipas Kriterit te dhenies se kontrates Oferta Ekonomikisht me e favorshme, ku nese perlogariten Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni i puneve te kryera 7 vite 10%, atehere oferta e rekomanduar eshte fituese edhe sikur te gjitha ofertat te ishin te pergjegjshme.

Mangësitë e vogla ne ofertën e OE te rekomanduar i konsiderojmë si devijime te vogla, konform nenit 59.4 te LPP-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. AK INVEST DOOEL TETOVO
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit